



KultArt
2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

SEZONI VEROR
20
23

KALENDARI ARTISTIK KORRIK 2023



“ËNDRRA IME, RINA”

Komedi romantike

Data: 02 korrik 2023

Ora: 20:00


Vendi: Teatri “Bylis”, Fier

Autor: Pëllumb Kulla

Regjisor: Spiro Duni

Produksion i Teatrit Kombëtar

Një regjisor teatri në prag pensioni dhe në prag divorci me gruan e tij, dhe situatat e ndryshme që krijohen nga ndërveprimet e tij me familjen, fëmijët dhe personazhet e ndryshme që vijnë në shtëpinë e tij për të kërkuar ndihmë profesionale. Një vështrim komik mbi familjen, problemet e saj dhe dukuritë sociale bashkëkohore.



“TË PARËT DHE TË FUNDIT”

Data: 1, 2 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Teatrin Metropol, salla Çehov.

Produksion i Fondit të Teatrit për të Rinj 2023 mbështetur nga Ministria e Kulturës, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe Teatri Metropol-Qendra Kulturore Tirana.

Autor: John Glasworthy

Regjia: Marius Dhrami

Skenografia: Erti Bejdo

Koreografia: Mario Bali

Grafic designer: Kevin Tarja

Me aktorët: Juli Emiri, Marius Dhrami, Xhino Musollari

“Të parët dhe të fundit” bazohet në tregimin e shkurtër të John Galsworthy-t të vitit 1917 me të njëjtin titull.

Jeta dhe mbiemri i avokatit të Këshillit Mbretëror, Keith Darrant (Marius Dhrami), respektohet dhe admirohet në të gjithë Londrën. Megjithatë, bota e tij vihet në rrezik kur vëllai i tij më i vogël, Larry (Xhino Musollari), shpërth-

en me lajme tronditëse.

“XHONI DHE XHOI”

Data: 7, 8 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Tepelenë

Produksion i Fondit të Teatrit për të Rinj 2023 mbështetur nga Ministria e Kulturës, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe Teatri Metropol-Qendra Kulturore Tirana.

Autor: Agota Christoph

Regjia: Endrit Ahmetaj

Skenografia/Kostumografi: Klea Lila

Me aktorët: Ana Guçe, Anxhelo Daut, Endrit Ahmetaj

Sinopsi: Xhoni dhe Xhoi, dy protagonistët e shfaqjes janë të burgosur në një ‘vend’, një bar surreal me tavolina dhe karrige në natyrë. Ata bien në konflikt për zotërimin e një lotarie të fituar. Mes dialogëve absurdë dhe paradokseve përpiqen të arrijnë fundin dhe të kapërcejnë gjendjen e tyre të pasigurt. Personazhet dhe situatat mbivendosen dhe ndërthuren aq shumë, sa të krijojnë një realitet që ndryshon vazhdimisht. Të qenit një dhe dy në të njëjtën kohë shkakton një surprizë që mund të kufizohet me zhgënjim dhe madje të bëhet sindromë, atë të ‘personalitetit të alternuar’. Ato mishërojnë dy mundësi të dalëshme në kuptimin ekzistencial.



“TESTAMENTI I RI”

Data: 08 dhe 09 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Arturbina, Salla 150

Produksion i TKEKS dhe UA

Autor: Sacha Guitry

Regjia: Alfred Trebicka

Skenografi: Beqo Nanaj

Kostumografi: Sofi Kara

Aktorët: Igli Fusha, Antonio Tole, Loris Sinanaj, Erli Fortuzi, Klaudio Gega, Klaudio Gjergji, Sofi Kotepano, Arsenilda Brojaj, Dajana Koci.

Pas njëzet vjetësh martesë, një mjek dhe gruaja e tij diskutojnë rreth marrëdhënies së tyre. Me leximin e parakohshëm të testamentit, të fshehtat dalin sheshit. Por pavarësisht këtij skandali, dukja dhe etika false duhet ruajtur.

MEDALIONI I HËNËS

Performancë poetike

Data 11 korrik 2023

Ora 21:00

Vendi: Torra Veneciane Durrës

Informacione & rezervime 0683913813



Një eksperiencë unike për të shijuar vargjet e Ismail Kadaresë që vijnë me zërat e aktorëve të mirënjohur të skenës e filmit shqiptar Yllka Mujo, Ndrizim Xhepa, Olta Daku, Xhelal Tafaj, Arben Derhemi & Anila Bisha. Një festë e teksteve më të bukur kadareane të sjellë në këngë nga Vikena Kamenica shoqëruar në flaut Daorsa Dervishi e në kitarë Arbër Çerri. Nën tingujt e dy mjeshtrave, kompozitorëve Haig Zacharian e Endri Sina vjen muza e dansit Vanesa Barushi. Koreografia: Joli Eleni Gjovreku. Idea & regjia: Driada Dervishi

“TANI KENI SY PËR TË PARË” (NOW YOU SEE HER)

Data: 14 korrik



Ora: 20:00

Vendi: Qendra Rinore “Arka”, Shkodër

Regjia: Klaudia Piroli

Autore: Lisa Karen Cox, Maggie Huculak, Raha Javanfar, Amy Nostbakken, Norah Sadava, and Cheyenne Scott.

Aktore: Loredana Gjeçi, Enisa Hysa, Denada Llanaj, Artemis Beluli

Kostumografia: Sofi Kara

Kompozitor: Eduart Hallulli

Poster Design: Alban Nimani

Shqipëroi: Adriana Tolka

Ndriçimi: Taulant Kotorri

Ato janë të padukshme, të harruara dhe të nënshtruara. Në një shpërthim lëvizjesh dhe fjalësh të përqendruara, pesë personazhe në “Noe You See Her” eksplorojnë disa

nga mënyrat e ndryshme se si gratë zhduken në kulturën tonë. Ato këndojnë, kërcëjnë dhe e hedhin veten në elementet e natyrës, ndërsa udhëtojnë nëpër stinët e jetës së tyre. Zërat e tyre janë sfidues. Pyetja e tyre është e thjeshtë: Pse dhe si e lejojmë fuqinë tonë të zhduket pa u përpjekur?

“GRATË TROJANE”

Data: 15, 16 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Arturbina, salla 150

Autor: Euripidi

Regjia: Altin Basha

Produksion i TKEKS - UA

Me aktorët: Theodhora Dhimo, Anxhela Muça, Greta Cani, Rafael Hoxhaj, Arlind Capi, Ivigina Hatiaj dhe Ina Zoto.

Vepra starton me fundin e luftës së Trojës, anijet e Akejve janë gati për t'u kthyer në Greqi. Femrat trojane janë të mbledhura si robinja lufte në port. Ato presin shortin që do t'i ndajë te komandantët grekë. Barbarizmi i sunduesve vazhdon deri në çastin e fundit të largimit të tyre. Gratë trojane dorëzohen si skllave te fituesit grekë.



“DIECI DANZE – DHJETË KËRCIME”

Le danzatrici en plain air 2023 contemporary dance festival

Data: 01, 06 korrik 2023

Ora: 20:00

Vendi: Bari, Itali

Data: 26.07.2023

Vendi: Fasano, Itali

Data: 27.07.2023

Vendi: Giovinazzo, Itali

Prodhim i the Menhir/Le Danzatrici en plain air 2023

Bashkëprodhim i Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” Tiranë, kompan-

ia shqiptare Dance Teater/ Festivali Shqiptar i Mbledhjes së Kërcimit 2023.

Koreografia: Giulio De Leo

Me: Mariel Brahimllari, Valentina Myteveli, Semela Skenderasi

Muzika: Sergio Altamura

Ndriçimi: Antonio Longo

Kostumografia: Sofi Kara

Bashkëpunëtor artistik: Carmelo Antonio Zapparrata

Dhjetë kërcimet - Tirana My Rhythm është një projekt koreografik i Giulio De Leo,

PROCESO ETERNO”

03 korrik 2023

Ora 19:30

Vendi: Salla e Katedrales Ortodokse në Tiranë

Hyrja e lirë!

Patricia Guerrero vjen në Tiranë për një spektakël të kërcimit flamengo të titulluar “Proceso Eterno”. Ajo e konsideron flamengon si pjesë të pashmangshme të identitetit të saj, njësoj si gjuha e nënës, e ky medium artistik e ndihmon atë të shprehë lirinë e brendshme të saj si interpretuese.

Guerrero është një profesioniste tej mase e vlerësuar e së fundmi është fituese e Çmimit Kombëtar të Kërcimit 2021 në Spanjë.

Ju presim në sallën e Katedrales Ortodokse në Tiranë për një mbrëmje që i përket artit dhe procesit të përrjetshëm të të shprehurit mes identitetit dhe kulturës.



“TIMO FLLOKO ME YJET NË BUTRINT”

Mbrëmje me poezi dhe këngë me vargje nga Timo Flloko

Data: 08 korrik 2023

Ora: 20:00

Vendi: Parku Kombëtar i Butrintit

Në mbrëmjen e 8 korrikut një ngjarje e shumëpritur artistike do të ndodhë në një nga perlat e trashëgimisë sonë kulturore.

Timo Flloko, aktor, poet, pedagog, një nga ikonat e kinematografisë shqiptare bën bashkë të tjerë personalitete të skenës, që nga Saimir Pirgu, te Nino Machaidze, Pirro Çako, Arilena Ara, Soni Malaj, Rovena Dilo, Redon Makashi, Marsela Çibukaj, Ledina Çelo dhe disa prej ish-studentëve të tij më të spikatur ndër vite Luiza Xhuvani, Ema Andrea, Nik Xhelilaj, Kristian Koroveshi.

Me praninë e Orkestrës së Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, nën dirigjimin e Jacopo Sipari di Pescasseroli.

Në 8 korrik, një mbrëmje mes muzikës dhe vargjeve të Timo Fllokos, nën regjinë e Vera Grabockës, mbështetur nga Ministria e Kulturës dhe TvKlan.

“SWING JAZZ- OPERA ON TOUR”

Data: 09 korrik 2023

Ora: 20:00

Vendi: Sarandë

Data: 16 korrik 2023

Ora: 20:00

Vendi: Shkodër

“Swing Jazz” një mbrëmje muzikore me një repertor gjithëpërfshirës, nga klasikja te muzika moderne dhe Jazz. Nën interpretimin e orkestrës simfonike të TKOB dhe solistëve lirikë, të cilët me zërin e tyre do të interpretojnë një program të freskët dhe të përshtatshëm për mbrëmjet verore.

Solistë lirikë: Vikena Kamenica, Renisa Lacka, Gerald Murrja.

PARADË “MAŽORETKINJE”

Java e Kulturës Malazeze

Data: 10 korrik 2023

Ora: 10.50-11.20

Vendi: Fillon te Reja dhe përfundon te Kalaja e Tiranës

Paradë e trupës Mažoretkinje

KONCERT I KUARTETIT TË HARQEVE TË ORKESTRËS SIMFONIKE TË MALIT TË ZI

Java e Kulturës Malazeze

Data: 13 korrik 2023

Ora 20.00

Vendi: Holli i TKOB

Kuarteti i harqeve të Orkestrës Simfonike Malazeze do të interpretojë këto vepra:

Ludwig van Beethoven: Kuarteti në C minor op.18 numër 4; Jozef Haydn: Kuarteti i harqeve në D minor op.76 nr.2

“AIDA”

Opera – Premierë

Data: 10-17 korrik 2023

Ora: 20:00

Vendi: Varna, Bullgari

Pas suksesit në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, produksioni madhështor i operës “Aida”, i cili mban autorësinë e regjisorit me famë botërore Franco Zeffirelli, udhëton drejt teatrit të Varnës.

Dirigjent: Jacopo Sipari di Pescasseroli

Regjia: Franco Zeffirelli / Stefano Trespidi

As/ Regjisor: Ada Gurra

Soliste lirike: Ivana Hoxha (Amneris)



“HUMUS”

Baleti

“Opera On Tour”

Data: 13 korrik 2023

Ora: 20:00

Vendi: Durrës

Data: 14 korrik 2023

Ora: 20:00

Vendi: Shëngjin

“Humus” është një himn për ekzistencën e natyrës dhe dashurisë për tokën. Historia se kujt i përkasim, kë duhet të mbrojmë dhe ku do të shkojmë.

Ka një sërë dimensionesh që trajtohen në këtë shfaqje, ku jo vetëm ekziston hapësira për argëtim, por mbi të gjitha do të ndërjegjësohemi për t'i hedhur sytë nga e ardhmja, e për të kontribuar shëndetshëm në favor të natyrës.

PORTO PALERMO FESTIVAL

Edicioni III

Data: 14 korrik 2023

Gëzim Myshketa dhe Agron Peni

Data: 15 korrik 2023

Kastriot Tusha, Josif Gjipali, Ardita Meni

Data: 21 korrik 2023

Eda Zari & AJS Quartet

Data: 22 korrik 2023

Elina Duni

Data: 28 korrik 2023

Sin Fronteras

Data: 29 korrik 2023

Marsela Çibukaj feat Vitmar Basha

Vendi: Kalaja e Porto Palermos

Festivali i Porto Palermos rikthehet ne edicionin e tij të tretë. Gjatë muajve korrik-gusht, festivali i krijuar nga violinisti Olen Çezari do të sjellë çdo fundjavë emra të mëdhenj të muzikës shqiptare dhe jo vetëm, si Gëzim Myshketa, Josif Gjipali, Eda Zari, Elina Duni, Ardita Meni, Marsela Çibukaj, Dren Abazi etj.

GJON MILI JAZZ & BLUES FESTIVAL

Edicioni II

Data: 12-15 korrik 2023

Ora: 20:30

Vendi: “Reja”, Tiranë

Edicioni i dytë i Gjon Mili Jazz & Blues Festival do të nisë nga Tirana, ditën e mërkurë, 12 korrik, ora 21:30.

Nata e parë e festivalit nis me Martin Listabarth (Piano solo) dhe Andi Kongo Quartet feat Olmo Chittó.

Për të vijuar në 13 dhe 15 korrik, ora 20:30, tek instalacioni “Reja” ku do të performojnë të tjerë artistë e grupe në edicionin II të Gjon Mili Jazz & Blues Festival.

“VJOSA IME”

Data: 08, 09 korrik 2023

Vendi: Tepelenë

“Vjosa ime” është një event dyditor në Tepelenë, ku do të për përfshijë zhanre të ndryshme: art, turizëm, muzikë, letërsi, teatër, pikturë, muzikë, panair, trashëgimi, eksplorim etj.

Gjatë dy ditë - netëve të titulluara “Vjosa ime” do të zhvillohen aktivitete, ku do të ndërthuren koncert me muzikë klasike, mbrëmje poetike, ekspozitë me libra, shfaqje teatri, panair me veshje të ndryshme popullore të krahinës, veshje të punuara me dorë, punime druri, metali, e më tej prodhime kulinarie tradicionale, bimësi medicinale etj. Gjatë këtyre aktiviteteve do të organizohen edhe ture me një guidë profesionale në pika kryesore që përfshijnë site të trashëgimisë kulturore si Ujëvara e Peshturës, Uji i Ftohtë, në grykëderdhje të Drinos ku lidhet me Vjosën etj.



DJ ED IS DEAD DHE VJ CAROLINA SAINZ

Java Kulturore Spanjolle

Data: 07 korrik 2023

Ora: 21:30

Vendi: Rruga "Brigada VIII" në Bllok

Java Kulturore Spanjolle përmbillet me një event muzikor ku do të luajnë DJ Ed is Dead dhe VJ Carolina Sainz!

Muzika elektronike e ndërthurur me tingujt e baterisë akustike, si dhe imazhet e kuruara nga Sainz do të përcjellin atmosferën e plotë të festës në rrugën "Brigada VIII" në Bllok.

"RICKY MARTIN DHE ORKESTRA SIMFONIKE E TKOB"

Opera Open Air

Pop Opera

Data: 20 korrik 2023

Ora: 21:00

Vendi: Sheshi Skënderbej, Tiranë

Një mbrëmje unike. Këngëtari me famë botërore Ricky Martin vjen në Tiranë për herë të parë duke realizuar një mbrëmje unike "Ricky Martin Symphonic" nën ekzekutimin e Orkestrës Simfonike të TKOB.

Dirigjent: Jacopo Sipari di Pescase-rolì.



"DUO MOTUS"

Ekspozitë e skulptorit Vladimir Llakaj

Data: Deri në 5 korrik 2023

Ora: 18:00

Vendi: Galeria e Artit "Vilson Kilica", Fier
Vladimir Llakaj e nis edukimin e tij artistik në liceun e Fierit, për ta vazhduar më pas fillimisht në Akademinë e Arteve në Tiranë, e prej aty në Aquila për t'u diplomuar në vitin 1996 në Akademinë e Arteve të Bolonjës, në atelierin e skulpturës monumentale të prof. Franco Franchi. Studiuesi dhe kuratori i ekspozitës Ermir Hoxha shprehet se në karrierën profesionale e artistike do të vinte dhe angazhimi i tij si pedagog i skulpturës në Universitetin e Arteve, ku do të instalonte dhe ekspozitat e tij më të fundme. Kështu, në galerinë e këtij institucioni (FAB) do merrni formë ekspozitat "Informal" (2018) dhe "My Dear Ones" (2022), të cilat do të serviroshin edhe njëherë për publikun në galerinë e qytetit të Fierit, nën titullin "Duo Motus" si një mundësi tjetër për të rivizituar krijimtarinë e tij.



"TERRITORE TË PËRVOJAVE TË JETUARA"

Ekspozitë

Data: 13 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: COD - Center For Openness And Dialogue

Qendra për Hapje dhe Dialog do të çelë ekspozitën me titull "Territore të përvojave të jetuara" nga artisti shqiptar Edi Hila. Veprat janë një përzgjedhje e autorit, të cilat shpërfaqin frymën e disa ndalesave të përkohshme gjatë një rrugëtimi. "Janë territore, krijesa e objekte që pulsojnë lehtas nën një rëndesë atmosferike, imazhe që reflektojnë përvojat dhe përjetimet e tij", thotë artisti Zef Paci.

"SAFET E GJYLZADE DOKLE"

Vendi: Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi"

Kurator: Lek M. Gjeloši

Muzeu "Marubi" prezanton ekspozitën personale të fotografëve Safet e Gjylzade Dokle, kuruar nga Lek M. Gjeloši. Aktiviteti fotografik i bashkëshortëve Safet e Gjylzade Dokle u zhvillua në Borje të rrethit të Kukësit e më gjerë, duke përkrahur një hark kohor 40-vjeçar, nga vitet '30 deri në fillim të viteve '70. Në kolek-

sionin e tyre fotografik dokumentohet historia politike, jeta shoqërore, ritualet e ndryshme dhe aspektet tradicionale të Shqipërisë Verilindore të asaj kohe. Ky koleksion, i cili përbëhet nga rreth njëzet mijë negativë, është më i madhi i dhuruar mbas viteve '90 në arkivin e Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi".



“TERRITORE TË PËRVOJAVE TË JETUARA”

Ekspozitë

Data: 13 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: COD - Center For Openness And Dialogue

Qendra për Hapje dhe Dialog do të çelë ekspozitën me titull “Territore të përvojave të jetuara” nga artisti shqiptar Edi Hila. Veprat janë një përzgjedhje e autorit, të cilat shpërfaqin frymën e disa ndalesave të përkohshme gjatë një rrugëtimi.

“Janë territore, krijesa e objekte që pulsojnë lehtas nën një rëndesë atmosferike, imazhe që reflektojnë përvojat dhe përjetimet e tij”, thotë artisti Zef Paci.

“DROPULL 2023”

Festivali Ndërkombëtar i Filmit me metrazh të shkurtër

Data: 03-06 korrik 2023

Vendi: Teatri antik i Adrianopolit

40 filma kryesisht të regjisorëve grekë, shqiptarë dhe kosovarë janë në konkurrim, 11 prej të cilëve filma të animuar për të rritur. Një pjesë e tyre u projektuan mbrëmë në amfiteatrin e Sofratikës, në Adrianopol, aty ku 2000 vjet më parë kanë interpretuar poetët, filozofët, oratorët dhe janë luajtur dramet e tragjeditë e mëdha të kohës.

Në festivalin e Dropullit konkurrojnë filma të metrazhit të shkurtër. Ata janë realizuar nga regjisorë të rinj e sjellin tematika të përditshmërisë. Ka filma që kanë në qendër forcën njerëzore mbijetesën dhe shpesh absurdin e diktuar prej zhvillimeve pa busull.

Festivali është një maratonë 4-ditore jo thjesht e filmit, por edhe artit pamor, vizatimit, muzikës, zakoneve e jetës lokale. Mbrëmja e parë, në teatrin antik të Adrianopolit, sollti një koncert në kitarë dhe një film të shkurtër grek të realizuar në vitet '60.

FESTIVALI I ARKITEKTURËS NË KOSOVË (KAF2023)

Data: 03-17 korrik

Vendi: Lapidariumi i Muzeut të Kosovës, Qendra kulturore historike, Kino ARMATA

Cili duhet të jetë kontributi ynë për një të ardhme më të qëndrueshme?

Kjo pyetje do të shtrohet në edicionin e 11-të të Festivalit të Arkitekturës në Kosovë (KAF2023) Tema e këtij viti është “Certain Uncertainties”, teksa ekspozita “Cities Connection Project” është një nga aktivitetet e para të edicionit të sivjetshëm.

Festivali i arkitektëve, planifikuesve e disenjuesve, premtor një program të pasur aktivitetesh, i cili është publikuar i plotë nga “Kosovo Architecture Festival”.

Pjesë e ngjarjeve do të jenë edhe hulumtues të përzgjedhur për të udhëhequr ligjërata e punëtori, që do të mbahen në hapësirat e qendrës kulturore historike, Kino ARMATA.

Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit e Kosovës është një nga mbështetësit kryesorë të KAF2023.



“TRAVEL FEST ALBANIA”

Data: 03-07 korrik 2023

Vendi: Tiranë, Durrës dhe Gjirokastrë

“Travel fest Albania” vjen në edicionin e dytë të maratonës filmike. Festivali do të zhvillohet deri në 7 korrik. Tirana, Durrësi dhe Gjirokastra do të mirëpresin mbi 50 kineastë dhe fotografë ndërkombëtarë, të bashkuar nga gjuha universale e filmit dhe e fotografisë.

Sipas organizatorëve të “Travel Fest Albania” këtë vit janë zgjeruar aktivitetet, duke

shfaqur më shumë filma, duke sjellë më shumë aktorë dhe duke zgjeruar shtrirjen gjeografike.

Prodhimet filmike do të sillen rreth temave të natyrës, mjedisit, turizmit, trashëgimisë dhe historisë, një përzierje bindëse që lidh të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Filmat e përzgjedhur do të shfaqen në dy lokacione në Tiranë: në Muzeun Kombëtar në mëngjes dhe në Amfiteatrin e Liqenit pasdite. Në Gjirokastrë fokusi do të jetë te turizmi e trashëgimia kulturore, ndërsa në Durrës filmat që lidhen me detin dhe kafshët e egra do të jenë në qendër të vëmendjes. “Travel Fest Albania” mbështetet nga Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Gjirokastrë dhe shumë partnerë të tjerë.

NET TË KINEMASË SPANJOLLE

Java Kulturore Spanjolle

Data: 04, 05, 06 korrik 2023

Ora: 21:00

Vendi: Te "Reja" në Tiranë

Për të apasionuarit e kinemasë, në Javën Kulturore Spanjolle është programuar një përzgjedhje filmash nga regjisorët dhe aktorët më të njohur të panoramës kinematografike spanjolle të ditëve të sotme.



Data: 04 korrik 2023

Ora: 21:00

SHFAQJE E FILMIT "MAR ADENTRO"

me regji të Alejandro Amenábar

Viti: 2004

Më shumë për filmin: Me një kast të aktorëve si Javier Bardem, Belén Rueda, Lola Dueñas, Mabel Rivera, ky film rrëfen historinë e Ramon Sampedros, i cili e ka shpenzuar jetën brenda mureve të shtëpisë pas një aksidenti në det, në rininë e tij. Vizioni i tij për botën dhe jetën ndryshon pasi Julia dhe Rosa vijnë në jetën e tij, duke ndikuar në

mënyrën e të menduarit se si ai do të vendosë ta lërë këtë botë. "Mar Adentro" është një film i vlerësuar gjerësisht me nominime për çmimin Oscar, Golden Globes dhe me trofeun Silver Lion të marrë në Venice Film Festival nga Javier Bardem, ndër shumë të tjera vlerësime.

Data: 05 korrik 2023

Ora: 21:00

SHFAQJE E FILMIT "15 AÑOS Y UN DÍA" (15 VJET DHE NJË DITË)

me regji të Gracia Querejeta

Viti: 2013

Më shumë për filmin: "15 años y un día" trajton marrëdhënien e komplikuar të një adoleshenti, Jon, me gjyshin e tij, një ish-ushtarak. Pasi Jon përjashtohet nga shkolla, nëna e tij e dërgon të qëndrojë pranë gjyshit të tij, për të mësuar më shumë për jetën, përgjegjshmërinë,



limitet, frikërat duke shpërfaqur kështu komplikimet e kësaj marrëdhënieje mes dy gjeneratave. Ky film ka pasur sukses të madh, duke marrë nominime dhe çmime në festivale prestigjioze të filmit si Goya Awards, Malaga Film Festival, Ariel Awards etj.

Data: 06 korrik 2023

Ora: 21:00

SHFAQJE E FILMIT "CAMPEONES" (KAMPIONËT)

me regji të Javier Fesser

Viti: 2018

Më shumë për filmin: "Campeones" është një dramë-ko-medi që rrëfen historinë e një trajneri spanjoll të basketbollit, që paraqitet me detyrën për të trajnuar një ekip, lojtarët e të cilit shfaqin vështirësi në mësim.

Ky film është vlerësuar gjerësisht në Spanjë me çmime dhe nominime në Goya Awards, Ariel Awards, Forqué Awards, Platino Awards etj.



"KOSTUME TRADICIONALE MALAZEZE"

Ekspozitë

Data: 10 korrik 2023

Ora: 11.20

Vendi: Kalaja e Tiranës

Ekspozita do të prezantojë kulturën e pasur materiale e shpirtërore të popullsisë në territorin e Malit të Zi të sotëm.

"LIBRA NË GJUHËN SHQIPE NGA KOLEKSIONET E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE ĐURĐE CRNOJEVIĆ"

Ekspozitë

Data: 10 korrik 2023

Ora: 11.20

Vendi: Kalaja e Tiranës

Ekspozita do të prezantojë një pjesë të koleksioneve të Bibliotekës Kombëtare kushtuar gjuhës shqipe

KINEMAJA MALAZEZE

Prezantimi i filmave kult malazezë

Data: 11, 12 korrik 2023

Ora: 20.15

Vendi: "Reja"

Ekranizim i filmit "Dječaci iz ulice", "Ace of Spades"

SHPLLJA E FITUESVE TË FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR FËMIJË

Data: 05 korrik 2023

Ora: 11:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Në praninë e ministres së Kulturës, Elva Margariti, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit do të shpallë fituesit e Fondit të krijimtarisë letrare për fëmijë. Mes 10 kandidatëve do të shpallen 3 fitues.

QKLL-ja mbështet procesin krijues të autorëve të letërsisë për fëmijë, si një letërsi e domosdoshme në rritjen dhe edukimin e brezave që vijnë. “Fondi për mbështetjen e krijimtarisë letrare për fëmijë”, do të vijojë të jetë ndër projektet bazë dhe të përvitshme të QKLL-së.

Thirrja u drejtohet autorëve mbi 18 vjeç në gjininë e prozës dhe poezisë për fëmijë dhe do të qëndrojë e hapur deri më datë 20.06.2023.

“NETËT E LIBRIT- HAPJA E TURIT VEROR 2023 - LIBRI DHE TURIZMI DURRËS”

Data: 07 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Kulla Veneciane, Durrës

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Bashkinë dhe bibliotekën e qytetit të Durrësit do të organizojnë aktivitetin letrar “Netët e librit”, në kuadër të projektit “Turi veror 2023 – Libri dhe Turizmi”.

Shkrimtarë shqiptarë nga e gjithë Shqipëria do të bëhen bashkë në një mbrëmje letrare, ku nuk do të mungojnë leximet, interpretimet dhe diskutimet letrare.



“VARG FESTIVAL”

Festivali i poezisë

Data: 18-21 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Durrës

“Varg Festival” synon të udhëtojë në qytetet turistike duke i dhënë jetë metaforës së takimit të vargjeve me valët në kuadër të fushatës “Libri dhe Turizmi” të ndërmarrë nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit përgjatë verës 2023, që synon të afrojë turizmin me kulturën jo vetëm përmes trashëgimisë kulturore, por edhe përmes aktiviteteve artistike në qytetet bregdetare e bregliqenore.

“Varg festival” vjen duke synuar të bashkojë krijues e lexues në skena letrare, jo vetëm si promovim për autorët, por edhe si grishje drejt librit shqip e lëvrimin të gjuhës shqipe.

“VARG FESTIVAL, SARANDË”

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Programi

Dita I

Data: 27 korrik 2023

Ora: 19:00 – 21:00

“Gjurmët e bregdetit jonian në letrat shqipe”

Në panel:

- Aleksandër Çipa
- Mimoza Ahmeti

Dita II

Data: 28 korrik 2023

Ora 19:00 -21:00

In memoriam Petro Marko

Në panel:

- Arianita Marko
- Behar Gjoka
- Aleksandër Çipa

Dita III

Data: 29 korrik 2023

Ora: 19:00 - 21:00

“Letërsia mikro”

Në panel:

- Odise Kote
- Poetët jonianë



FESTIVALI I 61-TË MBARËKOMBËTAR I KËNGËS PËR FËMIJË

Data: 04-06 korrik 2023

Vendi: Teatri "Migjeni", Shkodër

Ky festival bashkon zërat më të bukur të fëmijëve nga të gjitha trojet shqipfolëse. Aktiviteti do të zhvillohet në Teatrin "Migjeni", Shkodër. Festivali që mbledh fëmijë e artistë nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi e diaspora, organizohet nga Bashkia Shkodër, Qendra Kulturore e Fëmijëve "Kujtim Alija", Shoqata "Shpirti Artistik i Shkodrës", me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Radio Televizionit Shqiptar.

"TRE DERRKUCËT"

Data: 13 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Te meteori në pedonale, Golem

Data: 14 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Pedonalja në qytet, Divjakë
Shfaqje teatrale me kukulla, pjesë e turit veror 2023.

Regjia: Paolo Comentale.

Aktorët: Elidon Alike, Esmeralda Kame, Aleksandër Grami, Flori Kokona, Ilia Kaçi, Albana Kocaj, Jorida Meta.

Kohëzgjatja 30 min

Teatri i kukullave



"BORËBARDHA DHE SHTATË XHUXHËT"

Shfaqje teatrale me kukulla.

Data: 17 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Sheshi i Bashkisë, Orikum, Vlorë

Data: 18 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Parku i lojërave, Vlorë

Regjia: Aldjon Matarangasi

Aktorët: Jorida Meta

Kohëzgjatja 35 min.

"SHFAQJE ME NUMRA REPERTORI"

Cirk

Data: 05 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Durrës

Data: 07 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Krujë

Data: 12 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Velipojë

Data: 16 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Sarandë

Data: 19 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Shkodër

Numra artistikë nga 7 profilet e cirkut si kloun, lojëra interaktive me fëmijët nga klouni, numra artistikë me kafshë, ekuilibristë, zhonglerë, numra ajri dhe vertikalistë.

"ROZA DHE FATI"

Data: 03 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Sheshi pranë shatërvanit, Velipojë

Data: 04 korrik 2023

Ora: 19:00

Vendi: Sheshi përpara Bashkisë, Shkodër

Organizuar nga Teatri i kukullave, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

Regjia: Medi Gurra.

Aktorët: Elidon Alike, Esmeralda Kame, Aleksandër Grami, Flori Kokona, Ilia Kaçi

Kohëzgjatja 40 min.

"ARKEOLOGU I VOGËL"

Data: 14 korrik 2023

Ora: 10:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Data: 28 korrik 2023

Ora: 09:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar dhe Kampi veror

Fëmijët, të shoqëruar edhe nga mësuesja e tyre, si fillim do të bëjnë një guidë në muze.